



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Komuna e Drenasit

Kryetari i Komunës

Nr 01-400-49682 dt. 27/08 2019

Në zbatim të nenit 53 dhe 54 të Ligjit mbi Procedurën e përgjithshme administrative nr.05/L-031 të Republikës së Kosovës nenit 13 dhe 58 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 dhe nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, kryetari i Komunës bën këtë:

V E N D I M

I. ANULOHET në tërësi Vendimi 01 nr.400-49682 i dt.23.08.2019 lidhur me aprovimin e rekomandimit nr.04-400-49602 të datës 23.08.2019 të Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve të emërtuar Ndarja e Motokultivatorëve për fermerët nga Drejtorati për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural i Komunës së Drenasit nga ana e atij komisioni.

II. Obligohet Drejtorati për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural i Komunës së Drenasit që të kërkojë nga Zyra e Kryetarit të Komunës që të formoi komision tjetër profesional për rivlerësimin e aplikacioneve-dokumentacionit të fermerëve (konkurentve) për Motokultivator.

A r s y e t i m

Me vendimin 01.nr.400-49682 të datës 23.08.2019 është aprovuar rekomandimi nr. 04-400-49602 i datës 23.08.2019 të komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve-kërkesave të fermerëve për ndarjen e subvencioneve të emërtuar: Ndarja e Motokultivatorve për fermerët nga Drejtorati për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural i Komunës së Drenasit.

Pas verifikimit dhe shikimit të Regjistrit të përfituesve të këtij subvencioni përkatësisht motokultivatorve, u konstatua se përfitues të këtij subvencioni janë edhe disa shërbyes civil apo edhe familjar të ngushtë të tyre.

Pasi ky veprim i komisionit gjatë trajtimit të aplikacioneve- konkurentve konsiderohet jo real dhe konflikt i interesit, u maur vendim që të anulohet në tërësi puna e atij komisioni dhe rekomandimit të tyre.

Nga shkaqet e theksuara me lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë Organit Mbikëqyrës në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së tij.

Iu dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Drejtorisë së Bujqësisë;
- Arkivit Komunës së Drenasit;

